



ZYRA E PROKURIMIT

01 NR 351-41912/22

Date 14.12.2022

KONTRATË NR 102-2022

Numri i kontratës:¹ 634-22-12278-5-2-1/C537

KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

P-DELTA SH.P.K., Afrim Loxha 10, Prishtine, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Ndertim dhe renovim i objekteve shëndetsore faza II me numër identifikues: 634-22-12278-5-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Renovim i objekteve shëndetsore faza II sipas paramases nga njesia kerkuse**

No.	Lot
1	Ndertim dhe renovim i objekteve shëndetsore faza II

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **14,475.00 €**; [katëmdhejt mijë e katërqind e shtadhjet e pese Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka bërë Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3. Plani dinamik për kryerje të punëve është 30 ditë kalendarik

2.4. Sigurimi i Kontrates do të jetë në vlerë 1.450 €, me validitet 30+30= 60 ditë kalendarik

2.5 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

Sipas situacioneve mbi ekzkrutimin e punimeve , Me raport nga Organi mbikqyres .

Ruajtja e paras ne vlere 10 % nga Vlera e teresishme e kontrates do paguhet pas skadimit te garancionit prej 12 muajeve pas pranimit te perkoheshem teknik.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

Mostrat nga Ofeta

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet


4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.


Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Labinot Morina
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	14.12.2022
Vula:	

Për Kontraktuesin P-delta

Emri:	ARBON PREKADINI
Pozita:	PRONAR
Nënshkrimi:	
Data:	14.12.2022
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



RENOVIMI I SHTEPISE SE SE SHENDETIT- KLINË
PARAMASA DHE PARALLOGARIA

No	Pozicioni	Njësia	Sasia	Çmimi	Total
PUNET E DEMOLIMIT DHE DEMONTIMEVE					
1.1	Demolimi i mureve ekzistuese në katin e perdhës , muret me trashësi t=20 cm,hapja e hapësirave për dyer të caktuara në projekt dhe nga organi mbikëqyrës në cmim të përfshihet dhe transporti deri në deponi të caktuar nga organi mbikëqyrës.	m ²	15.00	5.00 €	75.00 €
1.2	Demontimi i dritareve) në katin e parë dhe gjatë demontimit të kihet kujdes në mos dëmtimin e tyre.	copë	1.00	20.00 €	20.00 €
1.3	Demontimi i dritareve (xhamave) në katin e parë tek barnatorja me dimensione 5x110 cm dhe gjatë demontimit të kihet kujdes në mos dëmtimin e tyre.	copë	1.00	10.00 €	10.00 €
1.4	Demolimi i dyerve nga druri në QPS dimensione 100x210 cm	copë	10.00	15.00 €	150.00 €
1.5	Demontimi i derës në katin e parë dimensione 100x210 cm dhe gjatë demontimit të kihet kujdes në mos dëmtimin e derës pasi të njëjta do të përdoret përsëri.	copë	2.00	10.00 €	20.00 €
Total:					275.00 €
1. PUNET E MURATIMIT DHE NDERTIMIT TË HAPESIRES E QKMF-së					
No	Pozicioni	Njësia	Sasia	Çmimi	Total

2.1	Furnizimi dhe muratimi i mureve me bllok siporeks t-15cm në pjesën e dhomave, suvatimi i këtyre mureve me llaq, vendosja e rrjetës, gjetim dhe llyerje me polikollor me ngjyrë të caktuar nga organi mbikqyrës në dy anet e mureve. Në cmim të përfshihen materiali lidhës dhe fugat.	m ²	15.00	40.00 €	600.00 €
Total:					600.00 €
2. PUNET E DYSHEMESE					
No	Pozicioni	Njësia	Sasia	Çmimi	Total
3.1	Furnizimi dhe montimi i qeramikës me dimensione 60x60cm dhomat dhe me ngjyrë dhe dizajn të caktuara nga organi mbikqyrës, në çmim të llogariten fugat dhe ngjitësi si dhe ngjitja vertikale në mure 5cm.	m ²	30.00	30.00 €	900.00 €
Total :					900.00 €
3. PUNET TJERA QARKULLUESE					
No	Pozicioni	Njësia	Sasia	Çmimi	Total
4.1	Montimi i dyerve të demotuara më parë në dy dhomat e Qkmf-së.	copë	2.00	25.00 €	50.00 €
4.2	Furnizimi transporti edhe montimi i dyerve nga druri me material folje PVC dhe me ngjyrë druri (Hardwood) si dhe me brava doreza dhe gomica me kualitetit si dhe me qelsa me dimensione 0.90x2.10. Dyret do të përzgjidhen nga organi mbikqyrës .Po ashtu dyret duhet të kenë pragje si dhe koriniza apo rame 17-20 cm.	copë	10.00	280.00 €	2,800.00 €
4.3	Furnizimi xhamve 5x5mm me folje për sportelin e barnatores e në katin e parë tek barnatorja me dimensione 5x110 cm	copë	1.00	100.00 €	100.00 €
4.4	Furnizimi transporti dhe montimi i dritares nga pvc me dimensione 1.40x2.00cm	copë	1.00	250.00 €	250.00 €
4.5	Furnizimi transporti edhe montimi i një dore me dimensione 0.90x2.10 nga Pvc	copë	1.00	250.00 €	250.00 €

4.6	Furnizimi dhe montimi I dollapave nga druri me dimensione 3.30 x 2.80 x 0.35 (2 copë) rendi I fundit horizontal duhet te jete me dollapa te mbyllur dhe rendi pare vertikal me xhama . Sipas projektit	copë	2.00	800.00 €	1,600.00 €
4.7	Furnizimi dhe montimi I nje tavoline nga druri me dimensione 3.00 x 0.80 x 0.80 plus 3 dollapa te vogel . Dhe nje dollap per fundi lavabos me dimensione 0.40x0.80x0.35	copë	2.00	450.00 €	900.00 €
4.8	Furnizimi transporti I 3 karrigave	copë	3.00	190.00 €	570.00 €
4.9	Furnizimi, transporti dhe lyerja e sipërfaqeve ë mureve dhe tavanit me ngjyrë polikollor yndyror ne dy shtresa, në llogari të hyjë edhe riparimi i pjesëve të dëmtuara, riparimi me rrjetë i mureve dhe tavanit i këndeve të dëmtuara, plasaritjeve dhe këndëve të shtyllave si dhe rreth dyerve dhe dritareve ne sallën e konferences.	m2	300.00	2.30 €	690.00 €
4.10	Furnizimi transporti dhe montimi I KLIMAVE - për flladitje gjatë verës dhe gjatë dimerit për ngrohje 24kw .Sipas specifikacioneve te kerkuara .Në qmim hyn dhe elmenetet tjera percjellse si tubat e tjera	copë	4.00	1,250.00 €	5,000.00 €
4.11	Ndrrimi i i gypave dhe elementeve tjera percjellese në QPS si dhe veshja me gips pllake ose me knauf për mbulimin e tyre si dhe ngjyrosja.	komplet	1.00	150.00 €	150.00 €
4.12	Debllokimi si dhe funksionalizimi dhe ndrrimi I lavabos ekzistuese , në llogari të futet dhe ndërrimi i gypave dhe elementeve tjera percjellese.	komplet	1.00	140.00 €	140.00 €
4.13	Furnizimi dhe montimi i trupave 5 ndriques LED në dhoma dhe në disa vende tjera të nevojshme në çmim përfshihet furnizimi me kabull adekuate dhe kyqja në rrjetin elektrik,paisja me ndërpreresit adekuat si dhe montimin 10 prizave,siguresave automatike,si dhe material i imet lidhes dhe montues i pa specifikuar.Si dhe rregullimi i kabllove instaluse	komplet	1.00	200.00 €	200.00 €
Total :					12,700.00 €

REKAPITULIMI	
	Çmimi
1. PUNET E DEMOLIMIT DHE DEMONTIMEVE	275.00 €
2. PUNET E MURATIMIT	600.00 €
3. PUNET E DYSHEMESE	900.00 €
4. PUNET TJERA QARKULLUSE	12,700.00 €
TOTAL:	14,475.00 €
Vërejtje: për të gjitha pozicionet që ka paqartësi dhe nevojiten sqarime shtesë të vizitohet hapësira për punishte, QKMF "Nënë Tereza" në Klinë.	

P-DELTA SHPK
23.11.2022
Prishtinë